



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
KOMISIONI INSTITUCIONAL ZGJEDHOR

Nr. 303 Prot.

Tiranë, më 23/11/2023

V E N D I M
Nr. 65 datë 23.11.2023

PËR
SHQYRTIMIN DHE MOSMIRATIMIN E ANKESËS ME NR.PROT 301, DATË
21.11.2023, DREJTUAR KOMISIONIT INSTITUCIONAL ZGJEDHOR TË
UNIVERSITETIT TË MJEKËSISË, TIRANË

Në bazë të Rregullores së Zgjedhjeve miratuar me Vendimin nr. 13, datë 12.02.2020 të Senatit Akademik “Për miratimin e Rregullores për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese dhe komisionet e përhershme në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë” i ndryshuar, Komisioni Institucional Zgjedhor i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, mori në shqyrtim ankesën e Z. Altin Ali Kuqo me nr. Prot.301, datë 21.11.2023, Për shkëljen e Rregullores në hartimin e fletës së votimit për zgjedhjen për anëtarë të KP në FM-UMT, Komisioni Institucional Zgjedhor në mbledhjen e datës 23.11.2023 shqyrtoi dokumentacionin,

BAZA LIGJORE DHE DOKUMENTACIONI I SHQYRTUAR:

- Ligji nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”;
- Rregullorja e Zgjedhjeve në UMT, e ndryshuar
- Statuti i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë
- Urdhrin nr. 159, datë 20.10.2023 të Rektorit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë
- Urdhrin nr. 160, datë 20.10.2023 të Rektorit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, “Për fillimin e procesit zgjedhor dhe caktimin e datës së zhvillimit të zgjedhjeve për Komisionin e Përhershëm për dhënien e gradës shkencore “Doktor” në nivel njësie kryesore, në të 3 (tri) njësitë në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë”, dhe bazuar në
- Vendimin nr.29, datë 3.11.2023 të KZF-FM “Për miratimin e listës paraprake të kandidatëve për anëtarë në Komisionin e Përhershëm për dhënien e gradës shkencore “Doktor” pranë Fakultetit të Mjekësisë, UMT” dhe tabelën e regjistrimit të kandidatëve aplikues
- Vendimin e KIZ nr.62, datë 07.11.2023 “Për miratimin e formatit të fletës së votimit në zgjedhjet për Komisionit e Përhershme në njësitë kryesore të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë”,
- Vendimin e Komisionit Zgjedhor të Fakultetit të Mjekësisë, nr.30, datë 20.11.2023
- Tabelën e rezultateve bashkëlidhur Vendimit nr.30, datë 20.11.2023 të KZF-FM,

- Dokumentacionin zyrtar për procesin zgjedhor të datës 20.11.2023 të publikuar në faqet zyrtare të internetit (<http://umed.edu.al/category/njoftime/zgjedhjet-per-autoritetet-drejtuese-ne-umt-2020/>) dhe (<http://www.fakultetimjekesise.edu.al>)

Komisioni Institucional Zgjedhor i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë pasi shqyrtoi ankimin e depozituar nga z. Altin Kuqo sipas objektit të sipërcituar si dhe dokumentacionit të ardhur nga KZ e Fakultetit të Mjekësisë, UMT për këtë çështje,

KONSTATON SE:

Miratimi i fletës së votimit me kandidatët për anëtarë në Komisionin e Përhershëm për dhënien e gradës shkencore “Doktor” në Fakultetin e Mjekësisë në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, (fleta e votimit Model 1), është bërë bazuar në Vendimin nr.29, datë 3.11.2023 të KZF-FM “Për miratimin e listës paraprake të kandidatëve për anëtarë në Komisionin e Përhershëm për dhënien e gradës shkencore “Doktor” pranë Fakultetit të Mjekësisë, UMT” bazuar në datën e aplikimit të kandidatëve, referuar tabelës së regjistrimit të kandidatëve aplikues, firmosur edhe nga z. Altin Kuqo. Kjo renditje sipas datës së regjistrimit është pakujdesi e cila është reflektuar në hartimin e fletës së votimit.

Prej datës 07.11.2023, lista paraprake e kandidatëve për Komisionin e Përhershëm në Fakultetin e mjekësisë dhe fleta e votimit e miratuar me Vendim të KIZ, miratuar nga Vendimin e KIZ nr.62, datë 07.11.2023, kanë qënë publike në faqet zyrtare të UMT dhe FM, të aksesueshme edhe nga kandidatët.

Bazuar në tabelën e rezultateve bashkëlidhur Vendimit nr.30, datë 20.11.2023 të KZF-FM, rezulton se z. Altin Kuqo ka marrë 79 vota nga 188 personel akademik i Fakultetit të Mjekësisë, duke e renditur atë të 12-tin.

KIZ ka marrë në shqyrtim tabelën e rezultateve të zgjedhjeve të zhvilluara në datën 20.11.2023 për Komisionin e Përhershëm për dhënien e gradës shkencore “Doktor” në Fakultetin e Mjekësisë në Universitetin e Mjekësisë. Referuar kësaj tabele, rezultojnë kandidatë të tjerë fitues (A. B 107 vota) por të renditur në pozicion të përafërt me z. Altin Kuqo. Kjo dëshmon se vendosja e emrit në fund të listës së fletës së votimit (me ose pa qëllim sikundër citon z. Altin Kuqo), nuk e ka penalizuar për tu kualifikuar si fitues.

KIZ konstaton se pavarësisht pasaktësisë në hartimin e fletës së votimit në zgjedhjet për Komisionin e Përhershëm për dhënien e gradës shkencore “Doktor” në Fakultetin e Mjekësisë në Universitetin e Mjekësisë, renditja e kandidatëve në fletën e votimit (Model 1) nuk e ka cënuar procesin zgjedhor në një masë të tillë që mund të ketë ndikuar në fitimin e mandateve sipas përcaktimeve të nenit 40, pika 1) b, të Rregullores së zgjedhjeve. Lista e kandidatëve në fletën e votimit është qartësisht e lexueshme dhe nuk identifikohen elementë të cilët pamundësojnë votuesin të ushtrojë të drejtën për të votuar sikundër rezulton me 79 votat e marra nga z. Kuqo apo kandidatë të tjerë fitues të renditur afër tij në fletën e votimit.

Nga sa më sipër, lidhur me ankimin e z. Altin Kuqo, bazuar në konstatimet e dhëna, KIZ;

VENDOSI:

1. Të pranohet pjesërisht pretendimin e Z.Altin Kuqo për renditjen e aplikantëve jo në rendin alfabetik nga pakujdesia në hartimin e fletës së votimit nga ana e KIZ duke u bazuar në renditjen e kandidatëve sipas datës së aplikimit dhe listës së hartuar nga KZF-FM

2. Të mos miratojë kërkesën e Z. Altin Kuqo për shpalljen e pavlefshmërisë së zgjedhjeve pasi nuk identifikohen elementë që mund të kenë ndikuar në fitimin e mandateve sipas përcaktimeve të nenit 40, pika 1) b të Rregullores së zgjedhjeve.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, afishohet në mjediset e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, publikohet në faqen zyrtare të internetit të UMT, një kopje e tij i dërgohet z. Altin Kuqo dhe KZF të Fakultetit të Mjekësisë të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë

KRYETAR
SILVANA BALA

